



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
— FERIZAJ —

Rektori
Prof. Dr. Agron Bajraktari

Nr. Prot.: 828/22; Datë: 14.03.2022

Në bazë të nenit 48, paragrafit 1.4 si dhe nenit 155, paragrafit 1 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) Senati i UShAF në mbledhjen e mbajtur me datën 14.03.2022, merr

V E N D I M

I.

Miratohet Rregullorja për përcaktimin fushës dhe lëmisë akademike (shkencore) me rastin e emërimit, avancimit ose rizgjedhjes së personelit të rregullt akademik në UShAF.

II.

Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

A r s y e t i m

Senati i UShAF për qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore në pajtim me Statutin e UShAF pas elaborimit të draft rregullores në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Senatit të UShAF;
2. Arkivit të UShAF;

Rektori
Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
— FERIZAJ —

Kryesuesi i Senatit
Prof. Dr. Agron Bajraktari

Nr. prot.: 828/22; Datë: 14.03.2022

Mbështetur në kompetencat e përcaktuara me nenin 48, paragrafin 1.4 dhe nenin 155, paragrafin 1 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Senati i UShAF në mbledhjen e datës 14.03.2022, miratoi:

R R E G U L L O R E

**PËR PËRCAKTIMIN FUSHËS DHE LËMISË AKADEMIKE (SHKENCORE)
ME RASTIN E EMËRIMIT, AVANCIMIT OSE RIZGJEDHJES SË
PERSONELIT TË RREGULLT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E
SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ**

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo Rregullore ka për qëllim rregullimin e procedurave për përcaktimin e fushës dhe lëmisë akademike me rastin e emërimit, avancimit ose rizgjedhjes së personelit të rregullt akademik në UShAF.
2. Sipas kësaj Rregulloreje, personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UShAF, me rastin e emërimit, avancimit ose rizgjedhjes do t'iu përcaktohet fusha dhe lëmia akademike (shkencore).

Neni 2

Procedura për përcaktimin e fushës dhe lëmisë akademike (shkencore)

1. Senati i UShAF me propozimin e njësive akademike dhe Këshillit Mësimor/Shkencor merr vendim për përcaktimin e fushës dhe lëmisë akademike (shkencore) me rastin e emërimit, avancimit ose rizgjedhjes së personelit të rregullt akademik në UShAF.
2. Me rastin e emërimit, avancimit ose rizgjedhjes, Senati me propozimin e Këshillit Mësimor/Shkencor në të njëjtën mbledhje merr vendim për përcaktimin e lëndëve mësimore me të cilat do të ngarkohet mësime mësimore.

Neni 3

Kohëzgjatja e thirrjes akademike dhe përcaktimit të lëndëve mësimore

1. Thirrja akademike për fushë dhe lëmi akademike (shkencore) do të jepet për një kohë të pacaktuar.
2. Vendimi për kohëzgjatjen e lëndëve të përcaktuara mund të ndryshoj me një vendim tjetër të Senatit sipas propozimit të Këshillit Mësimor/Shkencor varësisht nga kërkesat dhe nevojat e njësive akademike.

Neni 4

Dispozitat kalimtare

1. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore Senati i UShAF do të merr vendim për përcaktimin e fushës dhe lëmisë si dhe për përcaktimin e lëndëve mësimore sipas propozimit të Këshillit Mësimor/Shkencor të bazuar në kërkesat e njësive akademike për personelin akademik i cili ka fituar thirrjen akademike para hyrjes në fuqi të kësaj rregullore si në vijim:
 - 1.1. Personeli akademik i cili ka thirrjen akademike Profesor i Rregullt (Prof. Dr.);
 - 1.2. Personeli akademik i cili ka kontratë të punës në kohë të caktuar;
 - 1.3. Personeli akademik i cili ka kontratë pune në kohë të pacaktuar.

Neni 5

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senatin e UShAF.
2. Plotësimi dhe ndryshimi i kësaj rregullore bëhet nga Senati sipas mënyrës së njejtë të miratimit.

Kryesues i Senatit të UShAF,
Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI, Rector

